



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 85, datë 30.03.2021

MBI  
ZGJATJEN E AFATIT TË DORËZIMIT TË PROGRAMIT TË  
PËRPUTHSHMËRISË SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT PËR  
GAZIN NATYROR, ALBGAZ SH.A.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47, pika 1, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/6 prot., datë 29.03.2021 të për gatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtoria e Gazit Natyror,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 01.03.2021, ka vendosur:  
*Të fillojë procedurën për miratimin e Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “ALBGAZ” sh.a.;*
- Në vijim, duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria “ALBGAZ” sh.a., nuk ishte sqaruar ende plotësisht për përditësimin e konstatimeve të vendimit të bordit të ERE-s nr. 263/2020 në Programin e përputhshmërisë e mund të ishte i nevojshëm dhe organizimi i një takimi virtual për këtë qëllim si dhe duke mbajtur pasur parasysh faktin që shoqëria ishte në fazën e përkthimit të programit, i cili duhet dërguar dhe për opinionet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 01.03.2021, vendosi:  
*Zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s me 30 ditë, për miratimin e Programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “ALBGAZ” sh.a.*
- Me shkresën e datës 18.03.2021, shoqëria ka kërkuar zgjatjen deri më 10.08.2021, të afatit të dorëzimit të Programit të Përputhshmërisë, të përditësuar sipas konstatimeve të vendimit të bordit të ERE nr. 263, datë 28.12.2020, me anë të të cilit filloi dhe procedura për miratimin e këtij programi.

- Në mbështetje të kërkesës së saj për zgjatjen e afatit, shoqëria bëri me dije se, duke qenë se nuk u realizua dot një takim për shkak të kushteve të COVID-19, për të sqaruar përfundimisht çështjet e ngritura në vendimin për fillimin e procedurës, shoqëria deklaroi se ka nisur një procedurë të brendshme për implementimin e sugjerimeve dhe se ndryshimet në Programin e Përputhshmërisë duhet të miratohen në disa hallka drejtuese të brendshme të shoqërisë, si Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme e “ALBGAZ” sh.a.
- Lidhur me sa parashtruar nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a., në shkresën e datës 18.03.2021 sqarojmë se afati i kërkuar nuk është i justifikuar dhe për këtë arsye gjykohet shtyrja e tij me 3 muaj, përkatësisht deri më 30 Qershor 2021.
- Në nenin 53, pika 3, të Kodi të Procedurave Administrative, përcaktohet se:  
*3. Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*
- Kërkesa e shoqërisë është depozituar brenda afatit të shtyrë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 63/2021.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri më 30.06.2021 afatin e dorëzimit të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, ALBGAZ sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftoj palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**